



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:139788
Datë: 31.01.2024
Numri i dokumentit: 05267794
KE.nr.1018/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit N.T.SH. “Berveniku”, me NRB: 70444266, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Avokatura Istrefi” SH.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” SH.A., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.LI., me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës me datë 31.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit N.T.SH. “Berveniku”, me numër KE.nr.1018/22 e datës 21.10.2020, me objekt kontesti kompensim dëmi, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” SH.A..
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.SH. “Berveniku”, përmes të autorizuarit të tij, me datë 21.10.2020, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” SH.A., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, të detyrohet i padituri që paditësit për dëmin material të shkaktuar në automjetin e tij autobus Mercedes Benz, me targa ..., në fatkeqësi të komunikacionit, ashtu që t’ia kompensoj shumën prej 3,500.00 €, si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 1,500.00 €, të gjitha këto me kamat ligjore 8% duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, po ashtu të detyrohet i padituri që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Me datë 28.12.2023, përfaqësuesi i paditësit me anë të parashtrësës, e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar me datë 21.10.2020, për arsye se me të paditurin kanë arritur një pajtim jashtëgjyqësor.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së përfaqësuesit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1018/22, datë 31.01.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.